



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KESHILLI I BASHKISE DEVOLL

VENDIM

Nr 69 .Datë 27.12 2024

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2025 DHE PROGRAMIN BUXHETOR
AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2025-2027 TE BASHKISE DEVOLL

Keshilli I bashkise Devoll ne mbledhjen e dates 27.12.2024, me propozim te kryetarit te Bashkise , mbeshtetur ne nenin 9 pika 1.3 germa c,34,40,41,54 germa dh, te ligjit nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” I ndryshuar, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 te ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore” I ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, projekt-ligjit “ Per buxhetin e vitit 2024” udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 Për procedurat e Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisve të Vetqeverisjes Vendore”, Udhëzimit nr.03 date 28.02.2024 “ Per Pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” , Shkresës nr.17266 te Ministrise se financave date 17.12.2024 “ Dergohet per njoftim transferta e pakushtezuar dhe specifike per vitin 2025”:

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2025-2027, të Bashkise Devoll si më poshtë:

a. Miratimin e të ardhurave sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi për dy vitet e mëparshme dhe tre vitet e ardhshme .

Viti	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Vlera	697,620,000	687,811,000	724,975,916	751,089,520	769,431,275	786,147,933

b. Miratimin e fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore për cdo funksion për vitet 2025-2027 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

Programet	2025	2026	2027
AA105	183,911,760	182,371,759	181,871,759
AB105	243,460,453	271,766,566	305,014,487
AC105	38,240,555	40,394,296	40,694,296
AD105	214,563,355	204,787,000	204,787,000
AE105	70,913,397	69,111,654	52,780,391
AF105		1,000,000	1,000,000
Totali	751,089,520	769,431,275	786,147,933

c. Miratimin e tabelës te shpenzimeve për vitin 2025 sipas klasifikimit funksional pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

Klasifikimi	Paga (600)	Sig. Shoqerore (601)	Sh. Operative (602)	Tran. Instituc. (604)	Tran. Individe (606)	Investime (231)
Vlera	398,312,663	65,792,042	229,535,877	19,178,099	2,099,000	36,171,839

d. Miratimin e tabelës se fondeve buxhetore sipas programeve të ndara në korrente dhe kapitale për vitin 2025 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

Programet	Korrente	Kapitale
AA105	179,696,759.00	4,215,000.00
AB105	223,659,873.00	19,800,580.00
AC105	31,894,296.00	6,346,259.00
AD105	210,813,355.00	3,750,000.00
AE105	68,853,397.00	2,060,000.00
AF105	0	0
Totali	714,917,680.00	36,171,839.00

e. Miratimin e listës e investimeve për vitin 2025 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

f. Miratimin e tabelës me shpenzimet totale të Bashkisë për vitin 2025 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

Emertimi	2025	2026	2027
BURRIMET FINANCIARE			
• Te ardhurat nga burimet e veta	218,736,403	237,284,185	237,284,185
• Te ardhura nga taksat e ndara	25,725,115	25,725,115	25,725,115
• Transferta nga buxheti qendror	494,446,023	506,421,975	523,138,633
• Trashegimi nga viti kaluar	12,181,979	0	0
Totali I burimeve	751,089,520	769,431,275	786,147,933
Totali i Shpenzime Personeli (600-601)	464,104,705	464,104,705	464,104,705
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	250,812,976	250,812,976	250,812,976

Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	36,171,839	54,513,594	71,230,252
Totali i Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0
Totali i Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0
Totali shpenzimeve te buxhetit	751,089,520	769,431,275	786,147,933

2. Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Këshilli I Bashkisë Devoll miratoi vendimin me 12 vota pro, 0 kunder , 2 abstenim

Ky vendim u shpall më 06.01.2025

KRYETARI I KËSHILLIT

ALFREDI GJATA



Mr. 202 Prot
16.01.2025



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Set e Këshillit
te Shpendzave dhe
dy e rektorit op
Jy

Nr. 13/2 Prot.

Korçë, më 16.01.2025

Lënda: Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË DEVOLL

KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të vendimeve nr. 69, nr. 71, nr. 72, nr. 75, datë 27.12.2024, të Këshillit Bashkiak Devoll, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre**, bazuar në nenin 3, 8, 9, 22, 23, 25, 27, 34, 35, 40, 41, 54, 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, në ligjin nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", në udhëzimin nr. 3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027", në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17266, datë 17.12.2024 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar dhe specifike për vitin 2025", në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", në ligjin nr. 35/2023 "Për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarëve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi", i ndryshuar, në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me vendim Këshilli Ministrash nr. 503, datë 01.08.2024, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", shkallë vendi", i ndryshuar.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 76, datë 27.12.2024 "Për miratimin dhe shpërndarjen e fondeve, transferta e pakushtëzuar", institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur nëpërmjet shkresës prot. me tonën nr. 13/1, datë 09.01.2025.





BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMEVE FINANCIARE DHE BUXHETIT
SEKTORI I PLANIFIKIMIT TE BUXHETIT

RELACION

MBI

PROJEKT BUXHETIN E VITIT 2025 DHE PBA 2025-2027

Bilisht me 23.12.2024

Nr. 4178 prot.

PËRMBATJA

• Vizioni .	3
• Hyrje.	3
• Kuadri Ligjor.	3
• Te dhena gjeografike.	4
• Informacion i pergjithshem.	5
• Parimet themelore te Veteqeverisjes Vendore.	5
• Procesi i hartimit te programit buxhetor afatmesem dhe vjetor.	6
• Qellimet e Programit Buxhetor.	6
• Prioritete e buxhetit 2025.	8
• Burimet financiare.	9
<i>Taksat vendore.</i>	9
<i>Tarifat vendore.</i>	10
<i>Transferta e pakushtezuar.</i>	12
<i>Transferta specifike.</i>	13
• Shpenzimet e Bashkise Devoll.	15
<i>Struktura.</i>	15
<i>Shpenzimet e programit “Menaxhimi dhe Sherbimet Mbeshtetese”.</i>	16
<i>Shpenzimet e programit “ Sherbime Publike dhe Komunitare”.</i>	19
<i>Shpenzimet e programit “Sherbime Sociale”.</i>	22
<i>Shpenzimet e programit “Arsimi,Arti,Kultura dhe Sporti”.</i>	24
<i>Shpenzimet e programit “Buqesia, Mjedisi dhe Pyjet”.</i>	28
• Buxhetimi gjinor.	32
• Risku.	33
• Limiti i karburantit.	33

• **VIZIONI I ZHVILLIMIT DHE STRATEGJIA TERRITORIALE**

Bashkia Devoll hyrje e vendit, me një identitet të njohur në sajë të produkteve bujqësore, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit natyror, ka kushte banimi cilësore, është një destinacion ekoturizmi në nivel kombëtar dhe ofron mundësi për bujqësinë, turizmin dhe industrinë."

• **HYRJE**

Në Bashkinë e Devollit, sektori i bujqësisë dhe i përpunimit është që të jetë një sektor i rëndësishëm zhvillimi. Përshtatja e prodhimit me kërkesat e tregut, modernizimi i infrastrukturës mbështetëse, zgjerimi në tregje të reja. Në fushën e turizmit , kthimi i saj në destinacion ekoturizmi në nivel kombëtar, duke shfrytëzuar trashëgiminë e saj kulturore dhe mjedisin natyror dhe duke nxitur veprime në lidhje me forma të buta të turizmit alternativ si turizmi malor, agroturizmi etj. Duke pasur parasysh dhe pozicionin e saj si hyrje e Shqipërisë do të mund të krijojë bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar me qëllim lidhjen dhe zhvillimin e rrjeteve turistike tematike, si dhe promovimin e zonës së mbrojtur ndërkombëtarisht të Parkut Kombëtar të Prespës. Çdo zhvillim në sektorin e turizmit duhet të marrë parasysh mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit natyror dhe kulturor. Duhet të kultivohet ndërgjegjja mjedisore si e banorëve ashtu edhe vizitorëve dhe të merren masa për mbrojtjen e monumenteve dhe burimeve natyrore të Bashkisë. Në të njëjtën kohë duhet të ruajë kushtet cilësore të banimit që disponon, nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të urbanizuara, krijimit të mjeteve të qëndrueshme të transportit publik, përmirësimit dhe krijimit të hapësirave të reja publike, sigurimit të aksesit për njerëzit me lëvizshmëri të reduktuar, parandalimit të rreziqeve, përmirësimit të infrastrukturës shëndetësore, edukimit etj.

• **Kuadri ligjor**

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,

i ndryshuar;

Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

- **TË DHËNA GJEOGRAFIKE PËR TERRITORIN E BASHKISË DEVOLL**

Zona Gjeografike: Devolli kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 26.716 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 42.388 vetësh. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Devollit është një zonë që dominohet nga popullsia fshatare, sigurimi i të ardhurave të cilës mbështeten në dy burime kryesore, bujqësia dhe blegtoria nga njëra anë dhe remitancat nga emigracioni nga ana tjetër. Për shkak të pozicionit të saj kufitar me shtetin grek, një numër i konsiderueshëm banorësh kanë emigruar prej vitesh, duke gjeneruar të ardhura jo vetëm për veten e tyre por edhe për familjet e fshatrave

• **INFORMACION I PERGJITHSHEM**

		2020	2021	2022	2023	2024
Numri i Njësive Administrative	4					
Numri i Fshatrave	44					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	477					
<i>Qyteti</i>	4					
<i>Njësiti Administrative</i>	473					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	477					
<i>Zonë Urbane</i>						
<i>Tokë Bujqësore</i>	15,300					
<i>Kullota</i>	3,058					
<i>Pyje</i>	10,351					
Popullsia e Bashkisë		41,492	41,123	41,075	41,055	40,766
<i>Qyteti</i>		10,466	10,420	10,433	10,443	10,509
<i>Njësiti Administrative</i>		31,026	30,703	30,642	30,612	30,257
Mosha Mesatare e Popullsisë						
Numri i Lindjeve		121	109	93	99	
Numri i Vdekjeve		329	341	296	352	
Numri i Bizneseve Aktive		531	560	473	458	468
Numri i Familjeve		13,324	13,485	13,654	13,793	13,784
<i>Qyteti</i>		3,513	3,553	3,596	3,631	
<i>Njësiti Administrative</i>		9,811	9,932	10,058	10,162	
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë		304	367	380	395	410
<i>Administrata e Bashkisë</i>		304	367	380	395	410
<i>Njësiti Shpenzuese</i>		0	0	0	0	0
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Pjesëshme		0	0	0	0	
<i>Administrata e Bashkisë</i>		0	0	0	0	0
<i>Njësiti Shpenzuese</i>		0	0	0	0	0
Numri i Programeve Buxhetore		22	22	16	13	5

• **PARIMET THEMELORE TE FINANCAVE TE VETEQEVERISJES VENDORE**

1. Politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësiti e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.

4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

5. Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera.

6. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, padeficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

- **PROÇESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, VJETOR DHE ROLI I TIJ**

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë Devoll, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritarë të identifikuar në Programin e Bashkisë Devoll dhe në dokumentat e tjerë strategjikë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmësëm:

a. Përmiresimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e më përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

b. Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:

1. Një kuader i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
2. Forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

- **QELLIMET E PROGRAMIT BUXHETOR**

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke

përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifave vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësisia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe

- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Buxheti 2025 synon të informojë Këshillin Bashkiak Devoll dhe publikun e gjërë lidhur me planet e shpenzimeve të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të programit të Kryetarit të Bashkisë Devoll.

Dokumenti synon ti japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuader të qartë burimesh që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program iu shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikën fiskale dhe financiare të Bashkisë Devoll.

Gjithashtu, parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve dhe përcaktimi i fondeve afatmesme në dispozicion për investime, krijojnë mundësinë për vlerësimin e aftësive kredimarrëse të Bashkisë Devoll, dhe lejon në këtë mënyrë përdorimin e një instrumenti alternativ për rritjen e investimeve kapitale, të financuar nga burime të jashtme dhe të brendshme, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në dobi të komunitetit.

• **PRIORITETET PËR VITIN 2025**

Objektivi themelor i buxhetit do të jetë përmirësimi i procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe kthimi i Bashkisë Devoll në një zonë më të mirë për të jetuar. Ky objektivi do të realizohet përmes mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes, garantimit të cilësisë në tregjet publike dhe rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollorë; përmirësimin të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimit të shërbimeve sociale cilësore; meremetimit të infrastrukturës rrugore, përmirësimin të transportit publik, fuqizimit të rinisë dhe shtresave të tjera, rigjallërimit të jetës kulturore dhe masivizimit të sporteve; rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale.


Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit do të jenë pikërisht këto synime:

- ✓ Ofrimi i shërbimeve cilësore;
- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës arsimore;

- ✓ Përmiresimi i infrastrukturës dhe transportit;
- ✓ Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes;
- ✓ Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;
- ✓ Ndërtimi i veprave publike.

- **BURIMET FINANCIARE**

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Ne total buxheti per vitin 2025 shkon ne vleren 751 milion leke. Nga keto 45.6% mbulohet nga transferta e pakushtezuar, 20.1% nga transferta specifike, dhe 32.5 % nga te ardhurat e parshikuara dhe 1.6 nga transferta specifike e trasheguar nga viti 2024.



Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

1. **Taksat Vendore.**

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Taksat vendore janë parashikuar mbi numrin e bizneseve që operojne ne territorin e Bashkise Devoll. Per vitin 2025 jane parashikuar 498 biznese dhe per 3 vitet ne vazhdim jane parashikuar

nga 500-510 deri ne vitin 2026. Taksa e ndikimit ne infrastrukture zbatohet per zhvillimet qe kerkojne paisjen me leje ndertimi e cila llogaritet mbi cmimin reference ore preventivin e investimit te ri. Kjo takse llogaritet permes Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV); dhe Plan i Detajuar Vendor ne zonat te cilat do te kete zhvillim dhe prioritet . Ne total disponojme nje Plan te Përgjithshëm Vendor dhe nje Plan te Detajuar Vendor. Ne taksen mbi veprimtarine e shërbimit hotelier kemi parashikuar te ardhura mbi numrin e hoteleve te cilat parashikohet te jene te njejte ne numer per vitet 2025-2026. Numri total I hoteleve qe ushtrojne veprimtarine e pyre parashikohet 4.

2. Tarifat Vendore.

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave; b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet; ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit; d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve; dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore; ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

Ne tarifat per mbledhjen dhe largimin e mbledhjeve eshte parashikuar ne baze te numrit te pergjithshem te familjeve me 13.784 Ne tarifat vendore jane parshikuar edhe tarifate per cdo shërbim qe kryhen Bashkia. Ne total Bashkia kryhen 79 shërbime administrative per qytetaret. Per sa i takon tarifës se vendosur ne cerdhe eshte planifikuar per 28 femije te cilet trajtohen me ushqim.

Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike.

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, pronës, tokës dhe pajisjeve palëve të treta.

Bashkia Devoll disponon nje territor pyjor dhe kullosor me siperfaqe prej 13,643.9 ha nga e cilat siguron nje pjese te konsiderueshme te te ardhurave.

Të Ardhura të Tjera të Veta.

Të ardhurat e tjera përfshijnë ato të gjeneruara nga: pozicionet aksionare të bashkisë; ndëshkimet dhe gjobat; grante nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga qeveritë e huaja; etj.

Të ardhurat nga Taksat e Ndara.

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale.

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera. Per vitin 2025 ky ze eshte parashikuar 13,725,115 leke.

Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura.

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë. Kjo takse mblidhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Rrugor . Vitin 2025 eshte parashikuar ne vleren 12 milion leke.

Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare. Ne territorin tone nuk ka subjekte të licensuara për ushtrim aktiviteti në industrinë Minerare. Dhe për vitin 2025 parashikojmë 26,000 leke.

Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

Nr.	TAKSAT VENDORE	SHUMA	PESHA SPECIFIKE
1	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e B.V.	120,000	0.05%
1.1	Tatimi mbi të ardhurat personale	13,725,115	5.61%
2	Taksë mbi P.Paluajtshme	43,887,200	17.95%
a	-Taksa mbi ndërtesat	19,150,000	7.83%
b	-Taksa mbi tokën bujqësore	21,737,200	8.89%
c	-Taksa mbi truallin	3,000,000	1.23%
3	Taksa e fjetjes në hotel	75,000	0.03%
4	Taksa mbi kalimin e pronësisë për P.P	200,000	0.08%
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	1,300,000	0.53%
6	Taksa e regjistrimit të automjeteve	12,000,000	4.91%
7	Taksa e tabelës	2,000,000	0.82%
8	Taksa për dhënien e licencave për karburantet	4.600,000	1.88%
9	Të ardhurat nga të tretët	250,000	0.10%
	SHUMA E TAKSAVE	78,157,315	31.97%
Nr.	TARIFAT VENDORE		
1	Tarifë pastrimi	52,396,000	21.43%
2	Tarifë ndricimi	20,500,000	8.39%
3	Tarifë gjelbërimi	3,135,000	1.28%
4	Tarifa për Mirëmbajtjen e kanalizimeve të ujërave të zeza	6,000,000	2.45%
5	Taksa e zënies së hapësirave publike	1,440,000	0.59%
6	Tarifë për leja & certifikata transporti	790,000	0.32%

7	Tarifë leje non stop	200,000	0.08%
8	Tarifë parkimi	870,000	0.36%
9	Tarifë për shërbim varrimi	1,520,000	0.62%
10	Tarifë mirmbajtje varrezash	5,000,000	2.05%
11	Tarifa të ndryshme Bashkie	1,600,000	0.65%
12	Tarifa për qera trualli	29,165,569	11.93%
13	Tarifë Cerdhe	1,248,000	0.51%
14	Penalite (gjoba) kamatvonesa	2,000,000	0.82%
15	Tarifa mirmbajtje kanal kullues	8,780,000	3.59%
	SHUMA E TARIFAVE	134,644,569	55.08%
	SHUMA E DEBISE	31,659,634	12.95%
	SHUMA E TE ARDHURAVE	244,461,518	100.00%

3. Transferta e pakushtezuar

Transferta e pakushtezuar nga Buxheti i Shtetit u jepet njësive të vetëqeverisjes vendore për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Shuma totale vjetore e fondeve për tu ndarë ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertës së pakushtezuar, në një vit të dhënë buxhetor, është jo më pak se 1 % produktit të brendshëm bruto, të parashikuar në raportin për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuar nga Keshilli i Ministrave, sipas nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Në çdo rast, transferata e pakushtezuar nuk mund të jetë më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor. Me shkresën nr.17266 të Ministrisë së financave date 17.12.2024 "Dergohet për njoftim transferata e pakushtezuar dhe specifike për vitin 2025":


Krahasimisht me vitet e kaluara transferata e pakushtezuar ka pësuar rritje të konsiderueshme për vitin 2025. Në vitin 2025 për Transferatën e Pakushtezuar kemi një rritje me 70,809 mijë leke krahasuar me vitin 2024, Në planin e vitin 2025 është përfshirë edhe fondi për rritjen e pagave i cili parashikohet për këtë vit I cili është transferuar në vlerën 49,640 mijë leke.

Në 000/lekë

Viti	Shuma e transfertës	Rritja
2019	184,579	0
2020	189,509	4,930
2021	193,299	3,790

2022	199,230	5,931
2023	230,606	31,376
2024	272,047	41,441
2025	342,856	70,809

Në grafik paraqitet shpërndarja e grantit për 7 vite dhe vlerat përkatëse.



4. Transfertat specifike

Transfertat specifike financojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për:

- a) financimin e funksioneve të reja të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme ekuivalente dhe të qëndrueshme financimi;
- b) financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes të vitit buxhetor rezulton me fonde të papërdorura nga transfertat specifike për funksionin për të kryer funksionet e deleguara si më poshte:

1. Arsimi parashkollor, edukatore dhe punonjës në qendrat kulturore të fëmijëve.
2. Arsimi parauniversitar, punonjës të shërbimeve mbështetëse në arsimitë mesëm.
3. Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi (P.M.N.Z.Sh.).
4. Administrimi i pyjeve.
5. Administrimi i rrugëve rurale.
6. Administrimi i ujitjes dhe kullimi.
7. Emergjencat Civile .

Tabela mëposhtë jep tendencën e transfertës specifike për funksionet e transferuara. Në planin e vitin 2025 është përfshirë edhe fondi për rritjen e pagave i cili parashikohet për këtë vit.

Viti 2025 është viti i cili për bashkë të këtyre akordohet për herë të parë një fond për mbetjet urbane. Për këtë vit ky fond është 8,000 mijë lekë.

Viti	Shuma e transfertës specifike	Rritja
2019	92,411	0
2020	95,277	2,866
2021	100,948	5,671
2022	104,179	3,231
2023	108,560	4,381
2024	117,447	8,887
2025	151,590	34,143

Për kryerjen e këtyre shërbimeve Qeverisja Qëndrore ka përcaktuar dhe numrin e punonjësve për secilin sektor.

Nr.	Programi	Emërtimi i njësive shpenzuese	Nr i punonjësve
1	9120	Arsimi parashkollor	69
2	9230	Arsimi parauniversitar	4
3	3280	Emergjencat civile	14
4	4260	Administrimi i pyjeve	6
5	4240	Ujitja e kullimi	4
TOTALI			97

Për secilin funksion është bërë shpërndarja dhe përllogaritja sesi do të përdoren këto fonde. Kjo është rekomanduar nga Qeverisja Qëndrore dhe në kryejmë specifikimet përkatëse për shpenzimet operative të cilat përcaktohen duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të kaluar. Shpërndarja e fondeve është realizuar sipas tabelës së mëposhtme dhe programeve përkatës:

• **SHPENZIMET E BASHKISË DEVOLL PËR VITIN 2025**

Për buxhetin e vitit 2025 është parashikuar që shpërndarja e fondeve të bëhet në bazë të 5 programeve duke reflektuar dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave dhe në përputhje me formatet e reja të Instrumentit të Planifikimit Financiar.

1.STRUKTURA

Per vitin 2025 eshte parashikuar nje rritje punonjesish prej 34 punonjes te rinj krahasuar me vitin 2024 qe kishim 410.

(B2) STRUKTURA ORGANIZATIVE								
Kodi i Prog.	Emri i Programit	Strukturat Përbërëse të Programit	Drejtuasi i EMP (Emër/Mbiemër/Pozicioni)	Numri i punonjësve				
				2023	2024	2025	2026	2027
AA105	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim; Planifikimi urban; Shërbimet e policisë vendore ; Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Eliverta Pavliqoti- Zv.Kryetare	108	119	106	106	106
AB105	Shërbimet Publike Komunitare	Rrjeti rrugor rrurale; Shërbime publike vendore; Furnizimi me uje dhe kanalizime	Gentian Keco- Drejtori i Agj. Se shërbimeve Publike	88	85	124	124	124
AC105	Shërbimet Sociale	Perkujdesi dhe strehimi social	Zerina Sinani - Zv.Kryetare	30	31	24	24	24
AD105	Arsimi, Arti, Kultura & Sporti	Sport dhe Argetim; Trashegimi Kulturor, Evente artistike dhe kulturore; Astimi baze; Arsimi i mesem i pergjithshem	Xhensila Pine - Dr.e Agj.se Arsimit, kures, Rinise dhe Sporteve	133	136	152	152	152
AE105	Bujqësia, Mjedisi dhe Pyjet	Shërbime buqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe konsumatori; Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit; Administrimi I pyjeve dhe kullotave.	Astrit Seferkolli -Sekretar I Pergjithshem	36	39	38	38	38
	TOTALI			395	410	444	444	444

2.PROGRAMI AA105 “Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse”

Ky program përfshin: Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim; Planifikimi urban; Shërbimet e policisë vendore ; Mbrojtja nga zjarri dhe Mbrojtja civile. Qëllimi i këtij programi është menaxhimi i financave dhe burimeve njerëzore në përputhje me kuadrin ligjor dhe prokurimin publik në funksion të mirëqeverisjes së Bashkisë Devoll, sipas standarteve kombëtare ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Per vetqeverisjen Vendore”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT JANË:

Objektivi 1: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;

Objektivi 2: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve financiare;

Objektivi 3: Rritja e efikasitetit të zbatimit të procedurave të prokurimit publik.

Objektivi 4: Rritja e nivelit të vendimmarjes nga ana e Këshillit Bashkiak.

Në këtë program janë parashikuar shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për 106 punonjës sipas funksioneve të përcaktuara përkatësisht ;

PROGRAMI AA105 "MENAXHIMI DHE SHERBIME MBESHTESE"		Nr. punj.	Kodi I produktit	Burimi	Vlera Totale	FINANCIMI			
				i		01`	01`	05`	01`
				Fncimit		TPK	TS	TE ARDHUR A	TST
600	Paga	58	V111AAA	TPK	70,363,458	70,363,458			
600	Fondi vecante dhe F.largime			Te ardhura	2,000,000			2,000,000	
600	Fondi I pagave per rritje			TS	-				
601	Sigurime			TPK	11,750,640	11,750,640			
600	Paga	14	V314AAB	TPK	10,332,000	10,332,000			
600	Paga			Te ardhura	-				
601	Sigurime			TPK	1,725,528	1,725,528			
600	Paga	14	V328AAC	TS	16,428,153		16,428,153		
601	Sigurime			TS	2,743,476		2,743,476		
600	Paga	3	V328AAB	TPK	3,012,000	3,012,000			
601	Sigurime			TPK	503,016	503,016			
600	Paga	4	V614AAB	TPK	4,830,000	4,830,000			
601	Sigurime			TPK	806,618	806,618			
600	Paga	13	V614AAC	TPK	14,604,000	14,604,000			
600	Paga			Te ardhura	-	-			
601	Sigurime			TPK	2,438,916	2,438,916			
	PAGA&SIGURIME	106	-		141,537,805	120,366,176	19,171,629	2,000,000	-
602	Shperblim I Kryepleq		V111AAA	TPK	9,936,000	9,936,000			

602	Shperblim I keshilltareve		V111AAB	TPK	6,048,000	6,048,000			
602	Buxheti per Keshillin Bashkiak			Te ardhura	880,000			880,000	
602	Shpenzime gjyqesore			Te ardhura	500,000			500,000	
604	Keshillit te qarkut 1%			Te ardhura	-				
604	Dega e tatimeve			Te ardhura	-				
602	Kuota per Akademine e P.V			Te ardhura	319,384			319,384	
602	Qera trualli			Te ardhura	-				
602	Kancelari			Te ardhura	800,000			800,000	
602	Tonera			Te ardhura	-				
602	Dokumenta me vlere			Te ardhura	200,000			200,000	
602	Materiale per arkiven			Te ardhura	120,000			120,000	
602	Energji Elektrike			TPK	2,500,000	2,500,000			
602	Uje		V111AAD	TPK	500,000	500,000			
602	Sherbim interneti			TPK	600,000	600,000			
602	Sherbime postare			TPK	3,000,000	3,000,000			
602	Mirembajtje Web			Te ardhura	120,000			120,000	
602	Program Financiar			Te ardhura	120,000			120,000	
602	Ekspert te jashtem			Te ardhura	200,000			200,000	
602	Lyerje institucionet administrative			Te ardhura	-				
602	60 raste per kerkese info.ne ZVASHK			Te ardhura	115,000			115,000	
602	67 procedura regjistrimi te P.P.			Te ardhura	569,500			569,500	
602	Plane rievimi			Te ardhura	670,000			670,000	
602	Bare hipotekore			TPK	140,000	140,000			
602	Hartim PDV			Te ardhura	200,000			200,000	
602	Shpenzime udhetimi		V111AAH	Te ardhura	800,000			800,000	
602	Karburant			Te ardhura	864,000			864,000	
602	Uniforma			Te ardhura	910,000			910,000	
602	Tabela			Te ardhura	312,000			312,000	
602	Materiale pune		V314AAB	Te ardhura	400,000			400,000	
602	Sherbime mirembajtje automjeti			Te ardhura	300,000			300,000	
602	Kolaudim siguracion			Te ardhura	150,000			150,000	
602	Materiale pune			TST	150,000				150,000
602	Karburant		V328AAB	TST	172,800				172,800
	Karburant		V328AAC	TS /TST					

602					1,800,000		174,524		1,625,476
602	Uniforma			TST	392,000				392,000
602	Sherbime dhe materiale pune per Stacionin e MZSh			TST	485,000				485,000
602	Goma per mjetet			TST	70,000				70,000
602	Mirembajtje automjeti			TST	1,557,270				1,557,270
602	Siguracione dhe taksa			TST	120,000				120,000
602	Sigurimi I jetes per punonjesit			TST	378,000				378,000
602	Uje			TS	300,000		300,000		
602	Energji Elektrike			TS	400,000		400,000		
602	Materiale pune per IVMT		V614AAB	Te ardhura	60,000			60,000	
606	Fondi I Emergjences Civile		V091AAC	Te ardhura	1,000,000			1,000,000	
SHPENZIME TOTALE					38,158,954	22,724,000	874,524	9,609,884	4,950,546
231	Mobilje zyre		V111AAD	Te ardhura	65,000			65,000	
231	Shpronese		V111AAD	Te ardhura	500,000			500,000	
231	Blerje PC		V111AAD	Te ardhura	1,910,000			1,910,000	
231	Blerje PC		V328AAC	TST	200,000				200,000
231	Sistemi elektronik I taksave		V111AAD	TPK	1,540,000	1,540,000			
INVESTIME TOTALE					4,215,000	1,540,000	-	2,475,000	200,000
TOTALI I PROGRAMIT AA105					183,911,759	144,630,176	20,046,153	14,084,884	5,150,546

Tabela e mepostme ka te permbledhur zerat e shpenzimeve qe do te realizohen per vitin 2025 per kete program sipas llojit te klasifikimit.

Klasifikimi	Vlera Totale	TPK	TS	Të ardhura	TST
Paga 600	121,569,611	103,141,458	16,428,153	2,000,000	-
Sigurime 601	19,968,194	17,224,718	2,743,476	-	-
Shpz. Op. 602	37,158,954	22,724,000	874,524	8,609,884	4,950,546
Transferta Ins. 604	-				
Trans.Indiv. 606	1,000,000	-	-	1,000,000	-

Projekte 230	-				
Investime 231	4,215,000	1,540,000	-	2,475,000	200,000
Shuma	183,911,759	144,630,176	20,046,153	14,084,884	5,150,546

5. PROGRAMI AB105 “Shërbimet Publike Komunitare”

Ky program përfshin: Rrjeti rrugor rrurale, Shërbime publike vendore, Furnizimi me uje dhe kanalizime Qellimi I këtij program është ndikimi në cilësinë e jetës së qytetarëve të bashkisë përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore rurale dhe sinjalistikës të cilat janë nën administrimin e bashkisë dhe shërbimeve publike që përmirësojnë mobilitetin e qytetarëve. Mimbëajtja në kilometër e rrjetit rrugor, trotuarve dhe ndricimi të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ndërtimi dhe rehabilitimi i kanaeve të ujitjes dhe kullimit. Përmirësimi i meanxhimit të mbetjeve, ndotjes mjedisore dhe krijimit të hapsirave të gjelbërta brenda territorit të bashkisë, në funksion të shtesës së hapsirave rekreative.

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT JANË:

Objektivi 1: Mirëmbajtja dhe shtesa në kilometër i rrugëve rurale brenda territorit të bashkisë. Përmirësimi i sinjalistikës rrugore të bashkisë.

Objektivi 2: Mirembajtja e rrugëve në zonat urbane, rehabilitimi i rrugëve të reja, pastrimi dhe larja e tyre. Pastrimi dhe mirembajtja e trotuarëve si dhe stimi i sipërfaqeve të reja.

Objektivi 3: Rritja e efikasitetit të zbatimit të procedurave të prokurimit publik.

Objektivi 4: Rritja e sipërfaqes publike të pastruar dhe të mirembajtur në masën 90% (në sipërfaqe territoriale, koherente kjo me 100% përfitim i shërbimit nga familjet) në hapësirat e gjelbërta dhe në brenda blloqeve të pallateve Mbajtja e standartit 100% dhe për periudhën 2024-2028. Sipërfaqe publike të pastruar dhe të mirembajtur në njesitë administrative, dhe rehabilitim i varrezave, dhe shtim i sipërfaqes së tyre. Kryerja e kontrolleve të rregullta të mirembajtjes së kamioneve të pastrimit të mbeturinave, 6 kamione për Nj.A. dhe 2 mjete në qytet.

Objektivi 5: Mirembajtja dhe rehabilitimi i sipërfaqes së gjelbëruar në territorin e bashkisë Devoll. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i shërbimit të varrezave.

Objektivi 6: Sigurimi i një mbulimi efikas të energjisë për ndriçimin publik për 90% të zonës urbane dhe 80% në zonat rrurale të territorit të Bashkisë deri në 2026

Objektivi 7: Sigurimi i një mbulimi efikas të energjisë për ndriçimin publik për 90% të zonës urbane dhe 80% në zonat rrurale të territorit të Bashkisë deri në 2026

Në këtë program janë parashikuar shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për 124 punonjës sipas funksioneve të percaktuara perkatesisht ;

PROGRAMI AB105 " SHERBIME PUBLIKE DHE KOMUNITARE		Kodi I produktit	Burimi	Vlera Totale	FINANCIMI				
			i		01'	01'	05'	01'	
			Fnancimit		TPK	TS	TE ARDHURA	TST	
600	Paga	V452AAA	TPK	19,733,000	11,118,451		8,614,549		
			TS	13,293,565		13,293,565			
601	Sigurime		TPK	5,515,404	5,515,404				
600	Paga	V626AAA	TPK	46,359,600	11,589,900		34,769,700		
601	Sigurime		TPK	7,741,932	7,741,932				
600	Paga	V644AAA	TPK	4,983,600	4,983,600				
601	Sigurime		TPK	832,236	832,236				
PAGA&SIGURIME				98,459,337	41,781,523	13,293,565	43,384,249		
602	Cakull	V452AAB	Te ardhura	6,000,000			6,000,000		
602	Uje		TPK	900,000	900,000				
602	Pjese kembimi per automjetet e instutucionit		Te ardhura	10,000,000			10,000,000		
602	Blerje goma		Te ardhura	1,000,000			1,000,000		
602	Shpenzime mirmbajtje per goma te automjeteve		Te ardhura	320,000			320,000		
602	Siguracione dhe kolaudim makine		Te ardhura	2,000,000			2,000,000		
602	Karburant		Te ardhura	24,370,107			24,370,107		
602	Materiale hidraulike		Te ardhura	-					
602	Materiale ndertimi		Te ardhura	10,000,000			10,000,000		
602	Tuba per kanale		Te ardhura	5,000,000			5,000,000		
602	Kontrata e Sherbimit te Pastrimit		V510AAB	Te ardhura	4,783,000			4,783,000	
			V510AAC	Te ardhura	13,660,000			13,660,000	
		V510AAD	Te ardhura	19,869,856			19,869,856		
602	Sherbimi I largimit te mbetjeve urbane	V510AAF	Te ardhura	8,742,144		8,000,000	742,144		
602	Materiale ndertimi per vareza	V626AAB		-			-		
602	Blerje asfalti	V626AAC	TS	-					
602	Materiale per mirembajtje te objekteve	V626AAH		-					
602	Lule sezonale	V626AAD	Te ardhura	-					
602	Peme		Te ardhura	900,000			900,000		
602	Pleh kimik		Te ardhura	750,000			750,000		
602	Vegla pune		Te ardhura	1,000,000			1,000,000		
602	Materiale elektrike	V644AAB		4,000,000			4,000,000		
	Materiale elektrike	V644AAC	Te ardhura	1,000,000			1,000,000		
602	Energji Elektrike	V644AAB	TPK	4,905,429	4,000,000		905,429		

	Energji Elektrike	V644AAC		6,000,000	6,000,000			
SHPENZIME TOTALE				125,200,536	10,900,000	8,000,000	106,300,536	
231	Loti I "Rehab. I rrugëve të brendsh. Bilisht" 2023-2025	P452AAD	TPK	6,028,723	6,028,723			
231	Loti IV "Rehab.i rrugëve të fshatit Proger 2023-2025"	P452AAD	TPK	2,263,982	2,263,982			
231	Loti V "Rehab.i rrugëve të fshatit Miras 2023-2025"	P452AAD	TPK	3,517,842	3,517,842			
231	Loti II "Rehab.i rrugëve të fshatit Poncare 2023-2025"	P452AAD	TPK	3,405,140	3,405,140			
231	Loti III "Rehab.i rrugëve të fshatit Bitincke 2023-2025"	P452AAD	TPK	2,584,893	2,584,893			
231	Blerje automjet	V452AAB	Te ardhura	2,000,000			2,000,000	
INVESTIME TOTALE				19,800,580	17,800,580	-	2,000,000	
TOTALI I PROGRAMIT AB105				243,460,453	70,482,103	21,293,565	151,684,785	

Tabela e mëposhtme ka të përmbledhur zerat e shpenzimeve që do të realizohen për vitin 2025 për këtë program sipas llojit të klasifikimit.

Klasifikimi	Vlera Totale	TPK	TS	Të ardhura	TST
Paga 600	84,369,765	27,691,951	13,293,565	43,384,249	84,369,765
Sigurime 601	14,089,572	14,089,572	-	-	14,089,572
Shpz. Op. 602	125,200,536	10,900,000	8,000,000	106,300,536	125,200,536
Transferta Ins. 604	-	-	-	-	-
Trans.Indiv. 606	-	-	-	-	-
Projekte 230	-	-	-	-	-
Investime 231	19,800,580	17,800,580	-	2,000,000	19,800,580
Shuma	243,460,453	70,482,103	21,293,565	151,684,785	243,460,453

4.PROGRAMI AC105 “ Shërbimet Sociale”

Ky program përfshin: Perkujdesin dhe strehimi social. Ky program ka per qellim të garantoj funksionimin e një sistemi cilësor dhe të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të siguroj akses pa barriera për mirëqenie sociale me dinjitet, pa asnjë lloj diskriminimi, duke respektur të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT JANË:

Objektivi 1: Kujdesi social për familjet që përfirojnë shërbime nga Bashkia Devoll. Mbulimi i një numri sa më të madh i grupeve në nevojë të cilët sipas legjislacionit në fuqi duhet të përfitojnë nga shërbimet sociale.

